



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**MBI**  
**ADMINISTRIMIN E FONDIT TË GARANCISË DHE RREGULLAT E**  
**TRAJTIMIT TË DËMEVE TË KARTONIT JESHIL**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 190, datë 26.10.2021*

**Neni 1**  
**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat mbi administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil si dhe rregullat për trajtimin e dëmeve të Kartonit Jeshil.

**Neni 2**  
**Baza Ligjore**

Kjo Rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 38, pika 1 të Ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

**Neni 3**  
**Pajisja e Anëtarëve me Certifikatë Ndërkombëtare Sigurimi**

1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit autorizon shoqërinë e sigurimit (anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit) për të lëshuar Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Karton Jeshil) pas përmbushjes prej saj të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të kriterëve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në përputhje me rregullat e sistemit të Kartonit Jeshil.
2. Shoqëria e sigurimit (anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit) paraqet pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit, kërkesën për pajisje me Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Karton Jeshil) së bashku me një program të përshtatshëm risigurimi dhe garancinë bankare sipas kërkesave të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin

e transportit”.

3. Byroja depoziton në Autoritet një kopje të kërkesës së shoqërisë së sigurimit për pajisjen me Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Karton Jeshil) së bashku me programin e risigurimit. Byroja pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti për përshtatshmërinë ose jo të programit të risigurimit vijon me dhënien ose jo, të autorizimit anëtarit për të lëshuar Karton Jeshil.
4. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, në mbledhjen e radhës miraton ose jo dhënien e autorizimit anëtarit kërkues për shitjen e Certifikatës Ndërkombëtare të Sigurimit (Kartonit Jeshil).
5. Byroja njofton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare brenda 3 ditëve kalendarike për vendimin e Asamblesë të Përgjithshme të Anëtarëve për dhënien ose jo të autorizimit.

#### **Neni 4**

#### **Kriteret në përzgjedhjen e shoqërisë risiguruese**

Shoqëria e sigurimit për përzgjedhjen e shoqërive risiguruese, me të cilat lidh marrëveshje risigurimi, duhet të zbatojë Rregulloren “Për kriteret e risigurimit” të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si dhe kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Byrove.

#### **Neni 5**

#### **Fondi i Garancisë së Kartonit Jeshil**

1. Fondi i garancisë i kartonit jeshil krijohet dhe administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.
2. Çdo anëtar i Byrosë, i autorizuar për të lëshuar Karton Jeshil, duhet të depozitojë një garanci bankare pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të Byrosë, në shumën që përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, por jo më të vogël se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro.
3. Fondi i Garancisë së Kartonit Jeshil do të përdoret, sipas parashikimeve të nenit 37, pika 6 të Ligjit nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
4. Byroja pasi ka marrë njoftim për “*Guarantee Call*”, për mospërmbushjen e detyrimeve sipas parashikimeve të Rregullores të Brendshme të miratuar nga Këshilli i Byrove, njofton Anëtarin për këtë “*Guarantee Call*”. Në rast se Anëtari brenda 30 ditëve kalendarike nuk ekzekuton detyrimin, Drejtori Ekzekutiv i Byrosë autorizon pagesën e “*Guarantee Call*” nga Fondi i Garancisë së Kartonit Jeshil dhe njofton Anëtarin për plotësimin e detyrimit të krijuar në Fondin e Garancisë.

## **Neni 6**

### **Pagesa e dëmeve nga fondi i Kartonit Jeshil**

Fondi për pagesën e dëmeve të Kartonit Jeshil, sipas nenit 37 të Ligjit nr. 32/2021, përdoret për rastet:

1. Kur praktika e dëmit Karton Jeshil, trajtohet, përfaqësohet dhe paguhet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, në situatën kur nuk delegohet për trajtim/pagesë pranë një anëtari.
2. Kur nuk pranohet përgjegjësia e shoqërisë/byrosë homologe për dëmin Karton Jeshil të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Kur përgjegjësia për pagesën e dëmit të rrjedhur nga një automjet me regjistrim të huaj, ndodhet për shqyrtim/mendim/mediation/arbitrazh pranë Këshillit të Byrove.

## **Neni 7**

### **Trajtimi i Dëmeve Kartonit Jeshil me shkaktarë mjetet motorike me regjistrim të huaj**

1. Pala e dëmtuar nga një mjet motorik me regjistrim të huaj dhe me Certifikatë Ndërkombëtare Sigurimi apo dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe për mjetet me targë regjistrimi të vendit tjetër, nënshkruar të kësaj marrëveshjeje, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
2. Në rast se shkaktori i dëmit është i siguar tek një shoqëri e huaj e cila ka një korrespondent të miratuar për trajtimin e dëmeve që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë, Byroja Shqiptare e Sigurimit ia delegon praktikën e dëmit për trajtim dhe pagesë këtij korrespondenti.
3. Korrespondenti për trajtimin e dëmeve të Kartonit Jeshil në Republikën e Shqipërisë, mund të jetë një strukturë e specializuar si korrespondent që plotëson kriteret e nenit 28, pika 4 e Ligjit nr. 32/2021. Korrespondenti është i detyruar të njoftojë periodikisht (çdo muaj) Byronë Shqiptare të Sigurimit, për datën e pagesës së dëmit në favor të palës së tretë dhe vlerën përkatëse.
4. Në rast se shkaktori i dëmit është i siguar tek një shoqëri e huaj e cila nuk ka një korrespondent të miratuar për trajtimin e dëmeve që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë, kërkesa bëhet direkt tek Byroja Shqiptare e Sigurimit e cila autorizon për trajtimin e dëmit një nga shoqëritë e sigurimit - anëtare të Byrosë sipas një sistemi rotacioni.
5. Në rastet kur praktika e dëmit është hapur direkt nga një shoqëri anëtare e Byrosë

Shqiptare të Sigurimit, kjo e fundit pas marrjes së konfirmimit nga shoqëria përgjegjëse e huaj, njofton Byronë Shqiptare të Sigurimit e cila mund t'ia delegojë trajtimin dhe pagesën anëtarit të saj.

6. Në rast se mjete motorik me regjistrim të huaj shkaktar i dëmit nuk rezulton i siguruar me një Karton Jeshil të vlefshëm, i cili mund të jetë i falsifikuar apo i korrigjuar ose mjete qarkullon në territorin e Republikës së Shqipërisë i pasiguar, Byroja Shqiptare e Sigurimit zhvillon korrespondencën me byrotë homologe për zgjidhjen e rastit dhe në të njëjtën kohë autorizon një nga shoqëritë anëtare për trajtimin dhe vlerësimin e dëmit. Në këtë rast, në përfundim të korrespondencave me Byrotë homologe, do të përcaktohet statusi i praktikës së dëmit.
7. Të gjitha kërkesat për dëmshpërblim do të trajtohen nga korrespondentët apo anëtarët në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore që zbatohen në Republikën e Shqipërisë dhe në interesin më të mirë të siguruesit i cili ka lëshuar Kartonin Jeshil.

## **Neni 8**

### **Raportime dhe Informacione**

1. Shoqëritë e Sigurimit raportojnë pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit çdo tre muaj mbi dëmet e paguara dhe pezull të Kartoni Jeshil të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit informon çdo tremujor Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve për pagesë të shoqërive të sigurimit për dëmet e ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si edhe njoftimet për “*Guarantee Call*” që ka marrë.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit komunikon me të gjitha Byrotë homologe apo edhe ndërhyr pranë Këshillit të Byrove për çdo shqetësim të bërë prezent nga shoqëritë e sigurimit anëtare të saj, lidhur me procedurat e trajtimit të dëmeve nga Byrotë trajtuese të huaja.
4. Shoqëritë Anëtare të Byrosë, njoftojnë çdo muaj në Byro për praktikën e dëmeve të paguara dhe pezull Kartoni Jeshil për dëmet e ndodhura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Byroja publikon në faqen zyrtare listën e korrespondentëve dhe rregullat sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.